



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.98/17

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Lumni Sallauka e Arsim Hamzaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.B. nga Peja, R.B. nga Peja, paditësve të mitur A.B.1 dhe A.B.2, ku këta dy të fundit i përfaqëson përfaqësuesi i tyre ligjor – i ati i tyre N.B. nga Peja, e që të gjithë këta të përfaqësuar nga i autorizuari i tyre av.A.K. nga Prishtina, kundër të paditurëve Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë dhe Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës së parë BKS, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.345/15, të datës 27.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.04.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës së parë Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.345/15, i datës 27.10.2016, në pikën II të tij (në pjesët që ka të bëjë me dëmin e gjykuar jo material në emër të zvoglimit të aktivitetit të të përgjithshëm jetësor për të gjithë paditësit) dhe çështja për këtë bazë gjykohet si në vijim:

DETYROHET e paditura e parë Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material, si pasojë e aksidentit të shkaktuar në datën 06.08.2012, në fshatin Gllaviqicë në rrugën magjistrale Pejë – Prishtinë, t’ua paguaj shumat si në vijim:

a. Paditëses F.B.:

- në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shkallën 35%, shumën prej 10500 euro;

b. Paditëses R.B.:

- në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shkallën 5%, shumën prej 1500 euro;

c. Paditësit A.B.1:

- në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shkallën 5%, shumën prej 1500 euro;

c. Paditësit A.B.2:

- në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shkallën 5%, shumën prej 1500 euro; të gjithëve me kamatën në lartësi dhe kohë të llogaritjes sikurse që ka vendosur gjykata e shkallës së parë në pikën III të aktgjykimit të ankimuar.

Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve F.B., R.B., A.B.1 dhe A.B.2 që të gjithë nga Peja, për dëmin jomaterial në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, nga shumat e aprovuar si më lartë, e deri te shumat e kërkuara, **refuzohen si të pabazuara.**

II. REFUZOHET si pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës së parë Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.345/15, i datës 27.10.2016, në pjesët tjera të tij të pikës II (me përjashtim të pjesës së ndryshuar sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi), **VËRTETOHET.**

III. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës së parë Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.345/15, i datës 27.10.2016, në pikën III të tij (që ka të bëjë me kamatën e gjykuar për shumat e aprovuara dhe shpenzimet e aprovuara procedurale), **VËRTETOHET.**

IV. Aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.345/15, i datës 27.10.2016, në pjesën e tij me të cilën pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve F.B., R.B., A.B.1 dhe A.B.2 që të gjithë nga Peja, ndaj të paditurës së parë Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, është refuzuar si e pabazuar, si dhe pjesa me të cilën padia e paditësve F.B., R.B., A.B.1 dhe A.B.2 që të gjithë nga Peja, ndaj të paditurës së dytë Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, është konsideruar e tërhequr, **mbetet i pashqyrtuar.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve. Me pikën II të aktgjykimit është detyruar e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë që paditësve F.B., R.B., A.B.1 dhe A.B.2 që të gjithë nga Peja, t’ua kompenzon dëmin material dhe jomaterial si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 06.08.2012, shumat si në vijim: a) paditëses F.B., në emër të dëmit jomaterial, për dhimbje fizike, shumën prej 3000 euro, për zvoglim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 15000 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 2000 euro, për shëmtim 1000 euro; për dëmin material, për shpenzimet e mjekimit (terapi fizikale) shumën prej 59,9

euro; b) paditëses R.B., në emër të dëmit jomaterial, për dhimbje fizike shumë prej 2000 euro, për zvoglim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumë prej 4000 euro, për frikën e përjetuar, shumë prej 2000 euro; c) paditësit A.B.1, në emër të dëmit jomaterial, për dhimbje fizike shumë prej 3000 euro, për zvoglim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumë prej 5000 euro, për frikën e përjetuar, shumë prej 2000 euro, për shëmtim, shumë prej 2000 euro; d) paditësit A.B.2 në emër të dëmit jomaterial, për dhimbje fizike shumë prej 3000 euro, për zvoglim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 5000 euro, për frikën e përjetuar, shumë prej 2000 euro. Me pikën III të aktgjykimit është detyruar e paditura e parë Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë që paditësve F.B., R.B., A.B.1 dhe A.B.2 që të gjithë nga Peja, t'ua paguaj të gjitha prestimet e cekura sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, me kamatë ligjore siç e paguajnë bankat përkatëse për qytetarë pa destinim të caktuar për një vit, nga dita e nxerrjes së aktgjykimit 27.10.2016, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 3.455,00 euro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Pjesa tjetër e kërkespadi së paditësve F.B., R.B., A.B.1 dhe A.B.2 që të gjithë nga Peja, përtej pjesës aprovuese sikurse në pikën II dhe III të aktgjykimit për shpenzimet e procedurës është refuzuar si e pabazuar. Po ashtu është konsideruar e tërhequr padia e paditësve F.B., R.B., A.B.1 dhe A.B.2 që të gjithë nga Peja, e ushtruar kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S...", me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi me vlerës kontesti 119,250 euro.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura e parë Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallë së dytë ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësve, apo që çështjen ta kthej në rigjykim pranë gjykatës së shkallës së parë, apo që shumat e gjykuara t'i gjykoj dukshëm më ulët, duke pasur parasysh kontributin e paditësit si dhe suksesin e palëve në procedurë.

Paditësit nuk kanë paraqitur as ankesë e as përgjigje në ankesën e të paditurës së parë BKS.

E paditura e dytë KS "S...", nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e të paditurës BKS, është pjesërisht e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes të autorizuarit të tyre, me datën 24.12.2012, pranë gjykatës së shkallës së parë kanë parashtruar padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, kurse përgjatë procedurës e kanë zgjeruar edhe ndaj të paditurës së dytë KS "S...", me arsye sikurse në shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësve, pas mbajtjes së shqyrimin kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.345/15, të datës 27.10.2016, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve në raport me të paditurën e

parë BKS, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit aktgjykim. Ndaj të paditurës së dytë KS "S..." paditësit përmes të autorizuarit të tyre e kanë tërhequr padinë, pasi që në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, përkatësisht superekspertizës së bërë nga grupi i profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës, nr.1585, të datës 27.07.2016, në përbërje prej prof.dr.A.SH., msc.A.A. dhe Msc.G.H., është provuar se i siguruari i të paditurës së dytë, nuk ka ndikuar në shkaktimin e aksidentit të datës 06.08.2012, në të cilin paditësit kanë pësuar lëndime trupore. E për konstatimin e shkallës së lëndimeve të pësuar trupore dhe frikës së përjetuar të paditësve, gjykata e shkallës së parë ka caktuar ekspertët mjeko ligjor dr.E.M. - ortoped – traumatolog, dr.M.H. – psikiatër dhe dr.I.K. – ortoped (ku është konstatuar se si rrezultat i aksidentit në fjalë paditësit kanë pësuar lëndime të rënda trupore, më detalisht të përshkurara sikurse në ekspertizë dhe arsyetim të aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë) për çka duke u bazuar në nenet 154, 193, 200, 277 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e lidhur me nenin 323 të LPK, është vendosur që pjesërisht të aprtovohet kërkespadija e paditësve në raport me të paditurën e parë BKS. Vlen të ceket se përfaqësuesi i të paditurës së parë BKS, në fjalën e tij të fundit në seancën e datës 27.10.2016, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkespadiës së paditësve, por vetëm lartësinë e saj. Në raport me shpenzimet procedurale, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 452, 453 dhe 463 të LPK. Për arsye të cekura si më lartë, ndaj të paditurës së dytë paditësit e kanë tërhequr padinë e tyre.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, por gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar lartësinë e kërkesëpadiës së aprovuar në emër të dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore në emër të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për të gjithë paditësit, për çka u deshtë që aktgjykimi i atakuar në fjalë të ndryshohet dhe të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të gjykatës së shkallës së dytë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës së parë BKS se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjyimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjyimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiës së paditësve, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës së parë BKS për kompensimin e dëmit ndaj paditësve të lartcekur, e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së ekspertëve mjekoligjor dr.E.M. - ortoped – traumatolog, dr.M.H. – psikiatër dhe dr.I.K. – ortoped, si dhe superekspertizës së bërë nga grupi i profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës, nr.1585, të datës 27.07.2016, në përbërje prej

prof.dr.A.SH., msc.A.A. dhe Msc.G.H., i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Nuk qëndrojnë pretendimet e ankimore të të paditurës BKS për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes ekspertizave mjekësore të ekspertëve mjekësor nga lëmia e ortopedisë – traumatologjisë dhe psikiatrisë, të cekura si më lartë, për të cilat ekspertiza gjykata ka dhënë shpjegimet e saj në arsyetim të aktgjykimit ndërsa lidhur me dëmin material janë marrë për bazë provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës prandaj në këtë kontekst edhe Gjykata e Apelit i ka pranuar në tërësi vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë. Baza juridike e kërkespadiisë është sqaruar përmes superekspertizës së bërë nga grupi i profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës, nr.1585, të datës 27.07.2016, në përbërje prej prof.dr.A.SH., msc.A.A. dhe Msc.G.H., ku është konstatuar se shkaktari i aksidentit të datës 06.08.2012, ka qenë drejtuesi i autometit Audi, i cili nuk ka pasur mbulesë valide sigurimi.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës BKS për aplikimin e gabuar të drejtës materiale për shumën e gjykuar për paditësve në emër të dëmit jo material për dhimbjet e përjetuara shpirtërore në emër të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar dispozitën e nenit 200 të LMD, kur ka gjykuar forma të dëmit jo material për dhimbjet e përjetuara shpirtërore për shkak të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për të gjithë paditësit, pasi që shumat janë të larta dhe nuk u shkojnë përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit, prandaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditurës, e ndryshoi aktgjykimin e atakuar në pikën II të tij dhe gjykoi si në pikën I (nënpikat a, b, c dhe d) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore për zvoglim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për të gjithë paditësit, nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e të mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e gjykuara si në dispozitivin I (nënpikat a, b, c dhe d) të këtij aktgjykimi janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 të LMD, këto shuma përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që të dëmtuarit (në këtë rast paditësit) t'i përballojnë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me paragrafin 2 të nenit 200 të LMD përcaktohet se *“me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve të përjetuara, frikës së të dëmtuarve, si dhe dhimbjet shpirtërore për shkak të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ashtu që

kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësit i kanë pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 06.08.2012, e në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit.

Gjykata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën II të këtij aktgjykimi duke gjetur se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur në lidhje me pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, që ka të bëjë me dëmin e gjykuar jo material dhe material (për paditësen F.B. në emër të shpenzimeve të mjekimit) sikurse në pikën II të aktgjykimit të ankimuar, përveç pjesës së lartpërmendur e cila është ndryshuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dhe se shumata e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë adekuate dhe në përputhje me shkallën e të mirë nga e cila janë privuar paditësit si rezultat i aksidentit të datës 06.08.2012.

Edhe në raport me kamatën, gjykata e shkallës së dytë gjen se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 277 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, sikurse që edhe vendimi për shpenzimet procedurale është vendim i drejtë dhe i nxjerr në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK. Për këtë arsye edhe është vendosur sikurse në pikën III të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën IV të këtij aktgjykimi, pasi që në raport me pjesën e aktgjykimit me të cilën pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve F.B., R.B., A.B.1 dhe A.B.2 që të gjithë nga Peja, ndaj të paditurës së parë Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, është refuzuar si e pabazuar, si dhe pjesa me të cilën padia e paditësve F.B., R.B., A.B.1 dhe A.B.2 që të gjithë nga Peja, ndaj të paditurës së dytë Kompania e Sigurimeve "S...", me seli në Prishtinë, është konsideruar e tërhequr, nuk ka pasur pretendime ankimore, në ndërkohë që kjo pjesë e aktgjykimit të ankimuar është në favor të të paditurës BKS.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të të paditurës BKS, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika (d) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.98/17, me datën 22.04.2020

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj**